

## INFORMACIONE RRETH VLEFSHMËRISË SË GARANCISË

- Periudha e Garancisë për produktin që ju keni marrë tek ne, fillon kur ju bëhet dorëzimi i mallit nga transportuesi tek ju.
- Garancia ofrohet për blerësin direkt të mallit dhe jo për palë të treta.
- Garancia mbulon probleme të cila konstatohen nga ne si probleme fabrikimi/prodhimi.
- Nëse ju shfaqet problem që kompania e konstaton problem fabrikimi brenda muajit të parë të blerjes tek ne, ju ofrohet zëvendësim me mobilje të re të po të njëjtit model, ose në rast problem stoku me një model të ngjashëm.

Kategoria	Modeli	Afati	Cfare Mbulon Garancia
Këndet, Divanet	Të gjitha modelet	1 Vit	Strukturë Sfungjer Copë
Dyshekët	Eco Aloe	1 Vit	Shtresat e Dyshekut
	Eco Pocket + 3 shtresat	3 Vite	
	Modelet e tjera	5 Vite	
Dhomat e Gjimit	Të gjitha modelet	1 Vit	Aksesorët si: Mentasha, etj
Mobiljet e TV	Të gjitha modelet	1 Vit	Aksesorët si :pistona, Mentasha etj.
Kuzhinat	Të gjitha modelet	1 Vit	Aksesorë, mentesha, paneli.
Elektroshtepiakët	Elektra	2 Vite	Secili Model ka specifikat se cfare mbulon garancia. Kete dokument e gjeni ne paketimin e seciles prej elektroshtëpiakeve
Mobilje Tualeti	Të gjitha modelet	1 Vit	Aksesorët si menteshat etj.

### KËNDET:

Kompania mbulon brenda garancisë çdo model këndi apo divani për afatin kohor prej 1 viti. Garancia lidhet me strukturën e këndit, rënien drastike të sfungjerit, probleme të copë. Përsa i përket copës, strukturës apo sfungjerit, vetëm dëmtimet që vijnë nga këto pjesë të mobiljeve dhe konstatohen nga personat e autorizuar te kompanisë Bestseller SHPK, si dëmtime të ardhura nga probleme fabrikimi do të konsiderohen pjesë e garancisë, shpenzimet e të cilave mbulohen nga kompania.

**KUJDES:** Nëse ju zhvendosni këndin nga një ambient në tjetrin, duhet ta ngrini peshë dhe jo ta tërhiqni apo ta shtyni sepse rrezikoni ta dëmtoni fizikisht.

Nëse verifikohen si dëmtime fizike po nga personat e autorizuar të Bestseller, do informoheni nëse ka opSION riparimi si dhe do ju informohen nga shërbimi I klientit (044535000) kostot përkatëse.

### **Dyshekët:**

Në varësi të modelit ndryshon edhe afati I garancisë. Sic shihni në tabelën nr.1 Dysheku Eco Aloe ka 1 Vit garanci, Eco Pocket dhe modeli me 3 shtres kanë afat 3 Vite garanci ndërsa çdo model tjetër ka 5 Vite garanci. Gjatë këtyre afateve kohore, garancia mbulon dëmtime me natyrë problemin e fabrikimit vetëm për pjesën e përbërjes së shtresave. Nëse nuk janë problem fabrikimi kompania nuk e merr përsipër.

**KUJDES:** Shqepjet e tegelave, grisje apo dëmtime fizike të copës, apo dëmtime të shkaktuara nga mbipesha në përdorim nuk mbulohen nga garancia.

### **Dhomat e Gjimit:**

Afati kohor I garancisë është 1 Vit. Garancia mbulon vetëm aksesoret si ferramentët, menteshat, dorezat etj.

**SHËNIM:** Nëse shfaq një nga mobiljet problem dhe konstatohet problem fabrikimi që në muajin e parë të blerjes, kompania ofron ndërrim me të re. Melamina apo materiali MDF, janë kryesisht materiale që rezistojnë deri në 5 vite nëse mirëmbahen dhe kujdeseni me solucionet që përdorni. Mund ti referoheni dhe udhëzimeve në fund. Kujdes me zhvendosjen, gjithmone duhen ngritur peshë, nëse shtyhen apo tërhiqen mund ta dëmtoni mobiljen fizikisht. Nuk duhet të vendosni mbi peshën e paracaktuar, apo peshë mbi dollap.

### **Mobiljet e TV:**

Afati kohor për garancinë për çdo model të mobiljeve të televizorit është 1 vit. Brenda garancisë ne do ju ofrojmë shërbim për pistonat, aksesoret, menteshat etj nëse problem lidhet me fabrikimin.

Kujdes me vendosjen e sendeve të rënda tek pjesa e rafteve që varen në mur apo tek modulet.

**KUZHINAT:**

Të gjitha kuzhinat kanë afatin kohor prej një viti me garanci. Garancia mbulon vetëm pjesën e menteshave, aksesoreve, panelit.

**ELEKTROSHTËPIAKET:**

Të gjitha kanë garanci me afat kohor 2 vjeçar. Në paketimin që ju vjen ju keni një libër të cilit referojuni për udhëzime përdorimi apo pastrimi dhe mirëmbajtjeje si dhe një fletëpalosje që tregon në detaje se çfarë mbulon garancia si dhe kontaktet e servisit përkatës. Rastet merren përsipër vetëm nëse konstatohen probleme që vijnë si pasoje e fabrikimit.

**KUJDES:**

- solucionet që përdorni për pastrimin
- Luhatjet e tensionit sipas zonës (sygjerohet të përdorni mbrojtës tensioni)
- Ambjentin ku e përdorni të jetë sipas specifikave të produktit, kujdes lagështirën.
- Pozicionimin e tyre.

**MOBIJJE TUALETI:**

Afati kohor për garancinë është 1 Vit. Garancia mbulon aksesoret si menteshat, dorezat etj.

SYGJERIM: Mund të përdorni vida përforcuese nëse e varni mobiljen në mur.

**KINI PARASYSH:**

Garancia nuk merr përsipër defekte të cilat konsiderohen nga personat e autorizuar të kompanisë Best Seller SH.P.K si:

- Dëmtime fizike të shkaktuara nga përdorimi
- Dëmtime të shkaktuara nga solucione të papërshtatshme për materialin e mobiljes apo produktit që blihet pranë nesh.
  - Dëmtimet fizike aksidentale, nga abuzimi, keqpërdorimi, pakujdesia ose transportimi i papërshtatshëm.
  - Tentativa për riparime të produktit vetë nga ana juaj apo nga dikush që ju kontrakti.
  - Dëmtimet/defektet e shkaktuara nga:
    - Mosrespektimi i instruksioneve të produktit dhe përdorimit të tij.
    - Tjetërsimi i funksionalitetit apo keqpërdorimi i kapaciteteve të produktit.
    - Përdorimi i produktit në ambiente të papërshtatshme (pluhur, lagështirë , nxehtësi etj.
    - Materiale të lëngshme (ujë, etj), zjarri, shkaqe natyrore apo vjedhje.

## SHËNIM:

- Nëse produkti i plotëson kushtet standarde të pranimit në garanci, do të trajtohet në garanci pa asnjë shpenzim
- Nëse nuk i plotëson kushtet e trajtimit në garanci, klienti do të paguajë tarifën e shërbimit sipas tarifave të shërbimit tek klienti që përcakton kompania.
  - Zgjidhja e problematikave varion sipas afateve nga 5-10 ditë pune, zëvendësimet, ndërrimet apo dërgimi i një aksesori që mungon do zgjidhet maksimumi brenda 5 ditë pune.
  - Kompania, për produktet që merr përsipër brenda kushteve të garancisë, do ketë si proces të parë riparimin, nëse produkti rezulton me problem fabrikimi pas muajit të parë të blerjes.
  - Probleme që vijnë si pasojë montimi do konsiderohen nga kompania **vetëm nëse shërbimi i montimit është kryer nga palë e autorizuar nga kompania BEST SELLER SHPK.**

## KONTAKT:

Për çdo problem me blerjen tuaj tek ne gjatë periudhës që ju keni produktin brenda afatit kohor të ofruar për garancinë, ju lutemi kontaktoni në whatsapp në numrin 0697088842, duke raportuar me foto dhe video dëmtimin që produkti ka. Duhet gjithashtu të dërgoni foton e faturës.

**Garancia ka vlerë VETËM kur ju keni ruajtur faturën tatimore bashkangjitur me kuponin.**

## Mund të ndiqni procesin mëposhtë:

